



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:243935

Datë: 13.06.2022

Numri i dokumentit: 03127351

C.nr.2507/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve SH.D dhe F.D, nga Peja, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "NIKQI & Associates" (e përfaqësuar nga Haxhë Z. Nikçi, Arianit H. Nikçi, Zenel H. Nikçi dhe Tomor Xh. Taraku, Pranvera A. Shara dhe Shpetim A. Berisha) Sh.P.K, me seli në Pejë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, Rruga "Lidhja e Pejës", pa numër, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Diellza Sinani, juriste pranë paditurës, me objekt kontesti kompensim i dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të datës 19.05.2022, të mbajtur në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 03.06.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.D, nga Peja.

II. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, që paditëses F.D, nga Peja, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 31.10.2012, t'ia paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 1,020.00€

- Për friken e pësuar, shumën prej 714.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej 100.00€

- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 7.00€

III. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, që paditëses F.D, nga Peja, prestimet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 12% në vit, e cila për dëmin material llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë 24.10.2016, kurse për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, 03.06.2022, e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses F.D, nga Peja, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit jetësor t'ia paguaj shumën prej 2,000.00€, për shëmtim shuma prej 500.00€, për shpenzime të shërimit shuma prej 200.00€ si dhe si dhe dëmshpërblimin mbi shumat e aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe atë: për dhimbje trupore - fizike shuma prej 1,480.00€, për frikën e pësuar shuma prej 786.00€ dhe për përkujdesje të personit të huaj shumën prej 93.00€.

V. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit SH.D nga Peja, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit të pësuar në aksidentin e datës 31.10.2022, t'ia kompensoj shumat dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 2,500.00€, për frikën e përjetuar shumën prej 1,500.00€, për kujdes dhe ndihmë të huaj shumën prej 100.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 100.00€, për dhimbjet shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 2,000.00€, për shëmtim 500.00€ dhe për shpenzime të mjekimit 200.00€, të gjitha këto me kamatëvonesë, në lartësi prej 12% në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurë kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit.

VI. DETYROHET e paditura që paditëses F.D, nga Peja, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 739.20€ (shtatëqind e tridhjetë e nëntë euro e njëzet cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësit SH.D dhe F.D, nga Peja, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 24.10.2016, në këtë Gjykatë, kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Paditësit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kanë theksuar se me datë 31.10.2012, në rrugën Prishtinë – Ferizaj, saktësisht në fshatin Llapnasellë, afër kryqëzimit me hekurudhën, është shkaktuar aksident i komunikacionit rrugor. Pjesëmarrës në këtë aksident ishin automjeti i markës “Man-Flt”, me numër të targave, automjeti i markës “Man-Foxsb”, me numër të targavesi dhe automjeti i markës “Jeep-Grand”, me numër të targave, të cilin e ngjiste SH.D. Paditësi SH.D, ditën kritike ishte në cilësi të drejtuesit të automjetit, kurse paditësja F.D, në cilësinë e udhëtares (në automjetin). Të dy paditësit kanë pësuar lëndime trupore dhe janë dërguar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për ndihmë mjekësore. Ka shtuar se në procedurë penale, për shkaktarët e aksidentit, është marr aktgjykim me numër P.nr.263/13, të datës 30.05.2016, me të cilin vërtetohet baza juridike e kësaj kërkesë. Paditësit, me datë 13.08.2016, me kërkesë të veçantë i janë drejtuar të paditurës për realizim të dëmit, mirëpo e paditura nuk është përgjigjur kërkesës në fjalë. Mbi bazën e këtyre, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke e detyruar të paditurën që paditësve t’ia kompensoj dëmin material dhe jo material, në shumat e përcaktuara si në padi dhe precizim, me kamatë ligjore prej 12% në vit, e cila llogaritet për çdo ditë vonese duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 1,932.00€ dhe atë: për padi shumën prej 156.00€, për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 156.00€, për përfaqësimin e paditësve në katër seanca gjyqësore shumën prej 808.00€ (4 seanca nga 202.00€), në emër të shpenzimeve të mbylljes së zyrës për katër seanca të mbajtura shumën prej 202.00€ (808 x 25%), për nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit shumën prej 150.00€, për nxjerrjen e provave me ekspertizë të ortopedisë shumën prej 200.00€, për nxjerrjen e provave me ekspertizë të psikiatrisë shumën prej 200.00€ dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 60.00€.

E paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, në përgjigje në padi, seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë, me pretendimin se kërkesa

ndaj të paditurës është parashkruar konform dispozitës së nenit 362, paragrafi 3 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, nga se paditësit ka qenë në dijeni për rrjedhën e aksidentit nga data e aksidentit, në raportin policor me numër 212-AR-1968, ku është theksuar se aksidentit i kanë kontribuar të dy automjetet. Këtë e mbështet në faktin se në lidhje me dëmin material në automjeti, paditësi SH.D ka lidhur ujdë jashtë gjyqësore me të paditurën, me datë 14.12.2012, dhe nuk qëndrojnë pretendime se të njëjtit kanë rënë në dijeni për shkaktarin e aksidentit në vitin 2016, kur është nxjerr edhe aktgjykimi në procedurën penale. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve, ta refuzoj në tërësi si të pabazuar për shkak të parashkrimit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Raportin e aksidentit numër 212-AR-1968, të datës 31.10.2012 të lëshuar nga Policia e Kosovës, Raportin e Qendrës Emergjente me numër të protokollit 34762, të datës 13.10.2012 për SH.D, Raportin e Qendrës Emergjente me numër të protokollit 34763, të datës 13.10.2012 për F.D, Kërkesën për kompensimin e dëmit material dhe jo material të pësuar nga paditësit në aksident të datës 31.10.2012 dorëzuar të paditurës përmes postës me datë 16.08.2016, Ujdinë jashtë gjyqësore të datës 14.12.2019, Deklaratën e pranimit të riparimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit të datës 21.11.2012, Transferin nga kontoja me datë të pranimit në bankën ekonomike 26.12.2012, Aktgjykimi P.nr 2623/13 të datës 30.05.2016, Ekspertizën e komunikacionit të datës 27.10.2021 të punuar nga eksperti Behxhet Gerguri, Ekspertizat mjekësore të datës 23.12.2021, të punuar nga ekspertët mjekësor Vjollca Bince dhe Valbon Blakaj.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses F.D, ndërsa e refuzoj tërësisht kërkesëpadinë e paditësit SH.D, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndër-gjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datën se me datë 31.10.2012, në rrugën Prishtinë – Ferizaj, saktësisht në fshatin Llapnasellë, afër kryqëzimit me hekurudhën, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, mes automjeteve "Man Flt", me numër të targave, automjetit "Man-Foxsb" me numër të targavedhe automjetit "Jeep Grand" me numër të targave, në të cilin aksident paditësit, të cilit ishin ngasës (SH.D) respektivisht udhëtar (F.D), kishin pësuar lëndime, fakt ky që provohet edhe me raportin e aksidentit numër 212-AR-1968, të datës 31.10.2012, të përpiluar nga Policia e Kosovës dhe me

ekspertizën e komunikacionit rrugor të punuar nga eksperti Behxhet Gerguri, me datë 27.10.2021.

Nga Ekspertiza e Komunikacionit Rrugor datës 27.10.2021, e punuar nga eksperti Behxhet Gerguri, rezulton se shkaktar i aksidentit të datës 31.10.2012, janë ngasësit e automjeteve "Man Flt", me numër të targave (automjeti A) dhe Man Fox me numër të targave(automjeti B), ashtu që ngasësi i automjetit A, me të arritur në vendin kritik, duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme të sigurisë ndërmjet automjeteve, me pjesën e përparme ballore, të anës së djathtë, e godet automjetin C (automjetin 03612-AF të cilin e ngiste paditësi SH.D), në pjesën e pasme, i cili për shkak të një defekti ishte i ndaluar në shiritin e djathtë. Pas automjetit A, ka qenë duke lëvizur automjeti B, i cili poashtu duke mos mbajtur distancën e sigurisë ndërmjet automjeteve në lëvizje, i njëjti me pjesën e përparme ballore e kishte goditur në pjesën e pasme rimorkion e automjetit A. Në këtë mënyrë shkaktohet aksident trafiku rrugor. Deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të ngasësit të automjetit A dhe B. Në sqarimet e dhëna në seancë gjyqësore ka shtuar se nga rrjedha e aksidentit nuk ka mundur të vije në përfundim se me goditjet e automjetit B në automjetin A është shkaktuar ndonjë dëm në automjetin C (automjetin e paditësit SH.D) apo ka pasur rritje të vëllimit të dëmit në këtë automjet.

Gjykata ekspertizën e komunikacionit e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë, prandaj të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme pasi që edhe vet palët ndërgjyqësore nuk e kanë kontestuar.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet baza juridike, lartësia e kërkesëpadisë si dhe çështja e parashkrimit të kërkesës, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre.

Nga Raportet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - Qendra Emergjente, me numra 34762 dhe 34763, që të dy të datës 13.10.2012, Gjykata ka konstatuar faktin se në ditën e aksidentit, paditësit SH.D dhe F.D, janë paraqitur pranë këtij institucioni shëndetësor, i cili ka evidentuar lëndimet e paditësve dhe të njëjtit kanë pranuar edhe tretman mjekësor.

Nga kërkesa për kompensimin e dëmit material dhe jo material, drejtuar të paditurës, me datë të dorëzimit në postë 16.08.2016, gjykata ka provuar faktin se paditësit, në procedurë të rregullt kanë kërkuar nga e paditura dëmshpërblim, në shumë të përgjithshme prej 18,000.00€, për të gjitha format e dëmit, material dhe jomaterial.

Nga deklarata e pranimit të riparimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit të datës 21.11.2012, të dhënë nga SH.D, me numër personal, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi SH.D,

me këtë datë, nga auto servisi “Vëllëzërit Gashi”, ka pranuar automjetin me numër të targave, i dëmtuar në aksidentin e datës 31.10.2012, ashtu që Byroja Kosovare e Sigurimit, përmes servisit të kontraktuar, ka riparuar automjetin e paditësit.

Nga ujdia jashtëgjyqësore e datës 14.12.2019, e lidhur mes Bashkim Gashi dhe BKS dhe nga Transferi nga kontoja me datë të pranimit në bankën ekonomike 26.12.2012, gjykata ka provuar faktin se Byroja Kosovare e Sigurimit për shërbimet riparimin të dëmeve në automjetin e paditësit, të pësura në aksidentin e datës 31.10.2012, ka kompensuar servisin e kontraktuar në shumë prej 1,340.00€, e cila shumë është paguar në llogarinë bankare të kryesit të shërbimit, në ProCredit Bank.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me numër P.nr 2623/13, i datës 30.05.2016, Gjykata ka provuar faktin se ndaj shkaktarëve të aksidentit të datës 31.10.2012, është zhvilluar procedurë penale, kurse pala e dëmtuar në aksidentin në fjalë, SH.D dhe F.D, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës mjekësore, me ekspertë nga lëmi i Ortopedisë dhe Psikiatrisë. Ekspertiza është punuar me datë 23.12.2021 nga ekspertet Dr. Vjollca Bince – Ortopedisë dhe Dr. Valbone Blakaj Ramdani - Psikiatrisë.

Eksperti ortoped, Vjollca Bince, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi SH.D, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: ndrydhje e regjionit të qafës dhe ndrydhje në krahun e majtë. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 24 orë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë së ordinuar. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 18 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët kanë zgjatur edhe për 60 ditë të tjera dhe këto dhimbje kohë pas kohe vazhdojnë të jenë ende prezente. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, ekspertja ortoped ka theksuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 4 ditë, deri në adaptimin e qafores së butë Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë, për forcim të muskujve të regjionit të qafës dhe krahut të djathtë. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 7 ditë. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Valbone Blakaj Ramdani, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit

mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, e shfaqur prej momentit të goditjes së automjetit, zhvendosjes fizike të tij e deri në ndaljen përfundimtare, kur edhe ka përfunduar rreziku i drejtpërdrejtë për jetën. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 muaj, kurse frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje për 1 vit.

Eksperti ortoped, Vjollca Bince, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses F.D, ka konstatuar se si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësja, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: ndrydhje e regjionit të kokës. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 24 orë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë së ordinuar. Paditësja ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 15 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët kanë zgjatur edhe për 16 ditë të tjera. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka theksuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 24 orë, për shkak të kokë dhembjes dhe marramendjes. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 15 ditë, ushqim pasur me proteina, minerale, vitamina për përmirësim më të shpejtë të gjendjes pas ndrydhjes. Eksperti ka konstatuar se për paditësen nuk ka qenë i nevojshëm rehabilitimi fizioterapeutik, e njëjta nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor.

Gjykata, ekspertizat mjekësore, atë të ortopedisë dhe psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, të punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadisë është në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 (gazata zyrtare RSFJ numër 29, 26 maj 1978). Gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 pasi që dëmi është shkaktuar në kohën kur ligji në fjalë ka qenë në fuqi.

Me nenin 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, është përcaktuar mbulesa siguruuese, ashtu që sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik.

Kurse me nenin 10 të tij përcaktohet e drejta për kompensim për dëmin material dhe jo material, i cili duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 154 është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Me nenin 158 përcaktohet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkakuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.” Kurse me nenin 178, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se “Në rast aksidenti të shkakuar nga automjeti në lëvizje që është shkakuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullate mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë.”

Me nenin 155 të të ligjit në fjalë (LMD) përcaktohet se “Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshem) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psiqike (demi jomaterial).” Kurse me dispozitën e nenit 185, paragrafi 1 është përcaktuar mënyra e kompensimit të dëmit material, ashtu që me këtë dispozitë parashihet se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi.” Ndërsa me dispozitat e nenit 200 është rregulluar kompensimi në të holla i dëmit jo material, ashtu që sipas paragrafit 1 të nenit në fjalë “Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.”

Me nenin 360, paragrafi 1, Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 është përcaktuar se “Me parashkrimin pushon e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit“, kurse me nenin 361, është rregulluar çështja e fillimit të rrjedhjes së afatit të parashkrimit, ashtu që sipas këtij neni, dispozitës nga paragrafi 1 të tij, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Sipas dispozitave nga neni 376, paragrafi 1 dhe 2, “Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkakuar parashkruhet prë tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.” Ndërsa me nenin 377 është rregulluar çështja e parashkrimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit të shkakuar nga vepra penale.

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, gjykata gjen se pala e paditur është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar nga pala paditëse, kompensimi i palës së dëmtuar në aksident

bëhet mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia, konform nenit 154 dhe 178 Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 dhe nenit 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Megjithatë kërkesa e paditësit SH.D është përfshirë në parashkrim, në kuptim të nenit 376, paragrafi 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditëses F.D, vlerësimit në ekspertizave mjekësore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesëpadinë e paditëses F.D në shumë prej 1,020.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësja, si pasojë e aksidentit dhe lëndimeve të pësuarra prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 24 orë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 15 ditë, kurse dhimbjet me intensitet të ulët 16 ditë.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë për paditësen, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 714.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza nga lëmi i psikiatrisë është provuar se paditësja F.D, ka përjetuar frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët 1 vit (herë pas here).

Gjykata, vlerëson se shumatat e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'i mundësoj paditëses satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën do ta kishte po që se e njëjta nuk do t'i kishte humbur, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuarra, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 200 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë e kujdes të huaj, , ka

aprovuar shumat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 195, paragrafi 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978, ku është përcaktuar se “ Kush i shkakton tjetrit lezionim trupor ose ia prish shëndetin ka për detyrë t’i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditëses F.D i takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësja për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditëses i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjerëtanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Këto kategori të kompensimit, janë të njohura edhe me Rregullore për përcaktimin e kritereve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga auto përgjegjësia, e cila nuk është obliguese për gjykatat në rastin e vendosjes, por mund të merret si kriter orientues, rezulton se kompanitë e sigurimeve në rastet e aksidenteve të komunikacionit, të dëmtuarve u njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësen, ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditëses, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizë mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësja ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 15 ditëve, i pajisur me proteina, minerale, vitamina.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 7.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësja si pasojë e aksidentit, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, për shkak të kokë dhembjes dhe marramendjes. Kujdesi dhe ndihma nga personi i tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 24 orëve.

Gjykata, ka vendosur si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses F.D që ndërlidhet me dëmin jomaterial për dhimbje fizike – trupore dhe frikë, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Ndërsa sa i përket dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe për shëmtim, të cilat janë kërkuar

me padi fillestare dhe jo edhe me precizimin e datës 08.03.2022, e për të cilat nuk është tërhequr padia, gjykata ka refuzuar kërkesën e palës paditëse pasi që nuk është provuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka pasur shëmtim dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor.

Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në shumë prej 93.00€, për përkujdesje të personit të huaj, pasi që kompensimi i njohur prej 7.00€ është bazuar në praktikën gjyqësore për këtë lloj të kompensimit, përputhet në kohëzgjatjen e nevojës për përkujdesje të personit të huaj, që sipas mendimit të ekspertit ka qenë 24 orësh. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të mjekimit, të cilat janë kërkuar me padi fillestare dhe jo edhe me precizimin e datës 08.03.2022, e për të cilat nuk është tërhequr padia, gjykata ka refuzua kërkesën e palës paditëse, pasi që paditësja me asnjë provë nuk ka provuar shpenzimet e kërkuara me padinë e datës 24.10.2016.

Gjykata i ka vlerësuar si të bazuar pretendimet e të paditurës, Byroja Kosovare e Sigurimit, se kërkesa e paditëses F.D për dëmshpërblim është parashkruar. Kjo sepse aksidenti i komunikacionit, nga ku paditësja F.D, në cilësi të udhëtares në automjetin e aksidentuar, është dëmtuar ka ndodhur me datë me datë 31.10.2012, kurse padinë në gjykatë e ka ushtruar me datë 24.10.2016, që do të thotë se padia në gjykatë është ushtruar brenda afatit 5 vjeçar, të përcaktuar me dispozitën e nenit 376, paragrafi 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka provuar faktin se paditësja, në datën e aksidentit, ka qenë në automjetin me numër të targave, në cilësi të udhëtares dhe e njëjta nuk ka qenë në dijeni për personin që ka shkaktuar dëmin, në këtë rast të siguruarit e të paditurës. Për llogaritjen e afatit 3 vjeçar për parashkrim të kërkesës, bazuar në dispozitën e nenit 376, paragrafi 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978, paditësja duhet të ketë qenë në dijeni për dëmin dhe personin që e ka bërë dëmin. Këto dy kushte duhet të jenë të plotësuara në mënyrë kumulative. Në rastin konkret, paditësja për dëmin e pësuar ka qenë në dijeni në ditën e shkaktimit të tij, por e njëjta nuk ka qenë në dijeni për shkaktarin e dëmit, pasi që në aksidentin në fjalë kanë qenë të përfshira 3 automjete dhe e njëjta në cilësi të udhëtares nuk ka ditur për shkaktarin e vërtetë të dëmit. Lidhur me personin që ka shkaktuar dëmin, paditësja F.D, bazuar në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ka mësuar pas marrjes së aktgjyqimit në procedurë penale, aktgjykim ky i marr nga Gjykata Themelore në Prishtinë me numër P.nr.2623/16, i datës 30.05.2016, me të cilin i siguruari tek e paditura, Gani Uka dhe i siguruari tek ish Kompania e Sigurimeve “Insig”, B.SH, janë shpallur fajtor, kurse palët e dëmtuara në aksident për realizimin e kërkesës pasurore janë udhëzuar në kontest civil. Andaj, në vlerësimin e gjykatës, në rastin e paditëses F.D nuk aplikohet dispozita e nenit 376 paragrafi

1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978, por aplikohet dispozita e nenit 376, paragrafi 2 të të njëjtit ligj, e si e tillë kjo kërkesë nuk është përfshirë në parashkrim.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi bazuar nenin 26, paragrafi 6 Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, ku është përcaktuar se “Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë”. Kjo nga se pala e paditur nuk ka provuar që ka trajtuar dhe vendosur në kërkesën e palës së dëmtuar, në afatin 15 ditor për dëmin material dhe 60 ditor dëmin jomaterial, siç përcaktohet me dispozitën e nenit 26, paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Andaj, kamata në lartësi prej 12% në vit, për dëmin material fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë, që në këtë rast është 24.10.2016, brenda kufijve të kërkesës së palës, kurse për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 03.06.2022, e gjerë në përbushjen e plotë të detyrimit.

Gjykata ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit SH.D për dëmshpërblim të dëmit material dhe jo material, pasi që në vlerësimin e gjykatës kërkesa e paditësit është parashkruar.

Pala e paditur në këtë çështje juridike kontestimore ka paraqitur pretendim lidhur me parashkrimin e kërkesës, duke i ofruar gjykatës prova materiale për vërtetimin e fakteve dhe pretendimeve të saja. Nga provat e administruara, ujdia jashtë gjyqësore e datës 14.12.2019, Deklarata e pranimit të riparimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit, e datës 21.11.2012, Transferi nga kontoja me datë të pranimit në bankën ekonomike 26.12.2012, është provuar fakti se paditësi SH.D, në muajin Nëntor 2012, ka qenë i njoftuar edhe për personin që ka shkaktuar dëmin, në këtë rast të siguarin në Byronë Kosovare të Sigurimit. Kjo sepse i njëjti, në servisën e kontraktuar nga e paditura, ka riparuar dëmin e shkaktuar në automjetin e tij, i dëmtuar në aksidentin e datës 31.10.2012. Pra paditësi në datën e aksidentit ka qenë i njohur me dëmin që i është shkaktuar në aksident, ndërsa për personin që ka shkaktuar aksidentin ka qenë i njoftuar të paktën nga data 21.11.2012, kurse padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 24.10.2016. Pra padia e paditësit është ushtruar pas 3 vite nga koha kur ka ndodhur aksidenti dhe nga koha kur ka qenë në dijeni për shkaktarin e aksidentit, nga i cili aksident ka rrjedhur dëmi për të cilin kërkohet dëmshpërblimi. Mbi bazën e këtyre fakteve gjykata vlerëson se padia e paditësit SH.D

është përfshirë në parashkrim, në kuptim të nenit 376, paragrafi 1 të Ligjit Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifës së OAK-së. Ashtu që shpenzimet e procedurës së njohura në këtë çështje juridike i përkasin vetëm shpenzimeve të procedurës të krijuara nga paditësja F.D, kurse gjykata nuk ka njohur shpenzimet paditësit SH.D, pasi që kërkesëpadia e tij është refuzuar për shkak të parashkrimit.

Gjykata paditëses F.D i ka pranuar shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 739.20€, dhe atë: për padi shumën prej 104.00€, për përfaqësimin e paditëses në një seancë gjyqësore të përfaqësuar nga avokati (seancën e datës 19.05.2022) shumën prej 135.20€, për nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit shumën prej 150.00€, për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmi i ortopedisë shumën prej 150.00€, për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmi i psikiatrisë shumën prej 150.00€ dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 50.00€.

Gjykata paditëses F.D nuk i ka njohur shpenzimet e procedurës kontestimore për përfaqësim të paditëses në 3 seanca gjyqësore, secilën nga 135.20€ (apo shumën prej 405.60€), dhe atë për seancën e datës 25.05.2021, 05.10.2021 dhe 04.11.2021, kjo duke u bazuar në nenin 453 të Ligjit Nr.06/L-006 për procedurën kontestimore dhe nenin 1 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, pasi që në këto seanca paditësja është përfaqësuar nga bashkëpunëtori profesional në Shoqërinë e Avokatëve. Me nenin 1 të rregullores së lartcekur është përcaktuar se “Me këtë Rregullore përcaktohen pagesat tarifat për punën e avokatëve dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve.”, andaj nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se shpenzimet e përfaqësimit të përcaktuara me këtë rregullore njihen vetëm për avokat, por jo edhe për subjekte tjera që nuk janë të licencuar të kryejnë veprimtarinë e avokatit, që në rastin konkret rezulton të jetë bashkëpunëtori profesional në avokaturë, Tomor Xh. Taraku, i cili nuk është avokat.

Gjykata paditëses F.D nuk i ka njohur shpenzimet për precizimin e kërkesëpadisë (parashtresa e datës 08.03.2022), në vlerë prej 104.00€ (vlera sipas tariforit 6, për kontestet deri 10,000.00€ për 1 paditës, Rregullorja për Tarifat e Avokatëve), nga se në vlerësimin e gjykatës ky shpenzim është konsumuar me rastin e njohjes së shpenzimeve për përpilimin e padisë. Ky precizim nuk është si rrjedhojë e procesit kontestimor, paraqitjes së ndonjë kërkesë të re që derivon nga provat e reja të marra në procedurë kontestimore, por ka të bëjë vetëm me rritjen/zvogëlimin e kërkesës

në vlera monetare për kategoritë e dëmit material dhe jomaterial, dhe si i tillë ka mundur të bëhet në seancën e shqyrtimit kryesor.

Gjykata F.D nuk i ka njohur shpenzimet e procedurës për mbylljen e zyrës së avokatit për 4 seanca, në shumë prej 135.20€ (4 seanca x 135.20€ = 540.80€ x 25% = 135.20€), duke u bazuar në nenin 449, paragrafi 2 dhe 453 të Ligjit Nr.06/L-006 për procedurën kontestimore, pasi që pala paditëse vetëm në një seancë gjyqësore është përfaqësuar nga avokati, seanca e datës 19.05.2022, por edhe për faktin se në vlerësimin e gjykatës me rastin e njohjes së shpenzimeve për përfaqësimin në seanca gjyqësore është konsumuar edhe ky kompensim. Pala paditëse në këtë çështje juridike ka autorizuar për përfaqësim shoqëri të avokatëve, e cila sipas autorizimit që gjendet në shkresat e lëndës përbëhet nga gjashtë përfaqësues, ashtu që nuk është provuar mbyllja e zyrës në shoqërinë e avokatëve, në emër të të cilit (mbylljes së zyrës) kërkohet njohja e shpenzimit.

Gjykata nuk ka njohur shpenzimet tjera të krijuara në këtë çështje juridike kontestimore pasi që kanë të bëjnë me shpenzimet e krijuara nga paditësi SH.D, padia e të cilit është refuzuar për shkak të parashkrimit të kërkesës. Këto shpenzime përbëhen nga: taksa gjyqësore për padi 10.00€, pasi që kërkesa e paditësit ka rritur vlerën e kontestit mbi 5,000.00€ për çka taksa për padi është paguar 60.00€, kurse për vlerën fillestare të kontestit të paditëses F.D, prej 5,000.00€, taksa gjyqësore për padi është 50.00€; Për përfaqësim të paditësit në 4 seanca gjyqësore (1 seancë i përfaqësuar nga avokati dhe 3 nga bashkëpunëtori profesional), për secilën seancë nga 66.80€ (apo shumë prej 267.60€), për përpilim të padisë shumë prej 52.00€, për mbyllje të zyrës shumë prej 66.80€ dhe për precizimin e kërkesës shumë prej 52.00€, kjo duke u bazuar në Tarifat e Odës së Avokatëve të Kosovës, tariferi 6 dhe 7, për kontestet me vlerë deri 10,000.00€, nga se në këtë çështje juridike konsiderohet se paditësi SH.D është pala e dytë i përfaqësuar nga i njëjti përfaqësues, për të cilin tarifat e Odës së Avokatëve njoh shpërblim të avokatit në vlerën shtesë të kompensimit prej 50% të vlerës së kompensimit për një paditës. Ashtu që shumat në fjalë i referohen shpenzimeve të angazhimit të avokatit dhe shpenzimeve të kërkuara për përfaqësim nga përfaqësuesi jo avokat; Shpenzimet për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmi i Ortopedisë dhe Psikiatrisë, për secilën nga 50.00€, të cilat shpenzime janë krijuar nga paditësi si njëri nga dy paditësit, kjo bazuar në praktikën gjyqësore ku për secilin paditës lartësia e kompensimit të ekspertëve rritet në vlera të përcaktuara, e që në këtë rast, për të dy ekspertizat së bashku, vlera është prej 100.00€

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2507/16, datë 03.06.2022

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.